



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 53 datë 06.06.2017

“PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESIT TË BASHKISË SË TIRANËS NË MBLEDHJET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË “QENDRA TREGTARE E ZHVILLIMIT KULTUROR SHPK””

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1/ 1.1/shkronja (b), pikën 1/1.2, nenit 54, nenit 55 të Ligjit nr. 139/ 2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 140 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar ; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 29.03.2017 “Për transferimin e pronësisë së 45.11 % të kuotave të shoqërisë “Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor” shpk, Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia e Tiranës”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Aprovimin e ndryshimeve të kuotave të pronësisë të shoqërisë Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor shpk sipas VKM nr. 265, datë 29.03.2017 “Për transferimin e pronësisë së 45.11 % të kuotave të shoqërisë “Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor shpk”, Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia e Tiranës”, si dhe pasqyrimin e ndryshimeve në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.
2. Të caktojë Kryetarin e Bashkisë, si përfaqësues të Bashkisë së Tiranës ose personin e deleguar prej tij, në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor shpk, për shqyrtimin e ndryshimeve të akteve të shoqërisë sipas pikës 1 dhe në mbledhjet e tjera për çështje të veprimtarisë së zakonshme të shoqërisë.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI